



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

---

AD/GJTHPR/01/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga avokati R.K, ndaj gjyqtarit A.K, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullorës Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 14.01.2022 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. R.K, ndaj gjyqtarit A.K, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Avokati R.K me datë 29.12.2021 ka paraqitur ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.K në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me datë 11.01.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës.

Parashtruesi i ankesës av.R.K ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit A.K për shkak të pretendimeve se në lëndën P.nr.3269/21 (2021:016294) gjyqtari nuk e ka përpiluar aktgjykimin me kohë, për faktin se i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë me datë 02.12.2021 dhe se i njëjti është në paraburgim, dhe në rastet e tilla Kodi i Procedurës Penale ka paraparë veprime procedurale të përshpejtuara.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se, për lëndën P.nr.3269/21 është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi fillestar me datë 02.12.2021, ndërsa shpallja e aktgjykimi është bërë një ditë me vonë (me datë 03.12.2021). Sipas deklaratës së gjyqtarit, me datë 07.12.2021, lënda me të gjitha shkresat e saj është dërguar ne Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, sipas ankesës së mbrojtësve të të pandehurit, të ushtruar kundër aktvendimit për vazhdimin e masës së paraburgimit deri në plotfuqishmëri të aktgjykimimit, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Për më tepër, sipas gjyqtarit të çështjes, lënda me të gjitha shkresat e saj ka qëndruar në Gjykatën e Apelit, deri me datë 15.12.2021 (pasdite e pranuar ne zyrën e gjyqtarit), ndërsa afati për përpilimin e aktgjykimimit ka qenë deri me datë 17.12.2021 (afati 15 ditor konform nenit 369 par. 1 të KPP-së).

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklaramit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.K.

Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për shkeljen disiplinore lidhur me pretendimet se hartimi i aktgjykimit nuk është përpiluar brenda afatit ligjor, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë sepse nga shkresat e lëndës është konstatuar se lënda ka qenë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, sipas ankesës së mbrojtësve të të pandehurit prej datës 07.12.2021 deri me datë 15.12.2021, si dhe duke pasur parasysh afatin e shkurtër për përpilimin e aktgjykimi dhe ndërlikueshmërinë e çështjes, gjyqtari i rastit konform nenit 369 par. 1 të KPP-së, ka kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës zgjatjen e afatit për përpilimin me shkrim të aktgjykimit me numër P.nr.3269/21, edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë. Kryetarja e Gjykatës, me aktvendimin numër GJA.nr.793/2021, të datës 16.12.2021, e ka aprovuar zgjatjen e afatit për përpilimin me shkrim të aktgjykimit numër P.nr 3269/21, edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë shtesë. Ndërsa aktgjykimi është përpiluar me datë 29.12.2021, pra brenda afatit ligjor, dhe për këtë Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullorës Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/01/22, me datë 14.01.2022

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë